



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **140**

Prishtinë, më 4.3.2014, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Faton Topalli, Rasim Demiri, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina, Ramiz Lladrovci, Nijazi Idrizi, Boban Todorović.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 18.2.2014,
3. Plani Hapësinor “Monumenti i natyrës me rëndësi të veçantë Ujëvarat e Mirushës”,
4. Plani Hapësinor i Zonës me interes të veçantë të mbrojtur “Beteja e Koshares”,
5. Vendimi i Qeverisë nr.05/167/2014 për hartimin e planit hapësinor të parkut kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”,
6. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me ndryshime duke shtuar pikën për projektligjin e NP për Regjistrimin e bujqësisë dhe NP për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore. Njëherit kryetari i dëshiroi mirëseardhje deputetit Nijazi Idrizi tani në cilësinë e anëtarit të komisionit nga AAK.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 18.2.2014

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur me 18 shkurt 2014.

3. Plani Hapësinor “Monumenti i natyrës me rëndësi të veçantë Ujëvarat e Mirushës”

Lidhur me këtë plan hapësinor Kryetari **Nait Hasani** hapi diskutimin dhe njoftoi se dokumenti i dërguar në Kuvend është përmirësuar në aspektin tekniko formal nga stafi në bashkëpunim me zyrtarët e MMPH, ndaj komisioni përcolli mbledhjes plenare dhe votoi :

R e k o m a n d i m

Të miratohet nga mbledhja plenare Plani Hapësinor “Monumenti i Natyrës me rëndësi të Veçantë Ujëvarat e Mirushës” me ndryshimet si në origjinalin e rekomandimit me shkrim.

4. Plani Hapësinor i Zonës me interes të veçantë të mbrojtur “Beteja e Koshares”

Gjithashtu edhe për këtë plan hapësinor **Kryetari** sugjeroi procedimin sikurse për planin e mëparshëm me plotësime të duhura teknike, ndaj komisioni përcolli të njëjtën mbledhjes plenare dhe votoi :

R e k o m a n d i m

Të miratohet nga mbledhja plenare Plani Hapësinor Zona e Mbrojtur me Interes të Veçantë “Beteja e Koshares” me ndryshimet si në origjinalin e rekomandimit me shkrim.

5. Vendimi i Qeverisë nr.05/167/2014 për hartimin e planit hapësinor të parkut kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”

Rreth vendimit për hartimin e këtij plani, **kryetari** arsyetoi se kjo është ende fillimi i punës voluminoze sa i përket parkut nacional Bjeshkët e Nemuna, ndërkaq **Faton Topalli** pyeti a janë bërë studimet e duhura rreth këtij parku, me ç’rast **zyrtari i lartë i fushës Ylber Sherifi** njoftoi se studimi është bërë paraprakisht para se të shpallet ky park nacional, ndërsa me këtë vendim i cili do të miratohet në Kuvend, do të fillojnë përgatitja e planit hapësinor që është obligim ligjor, ndaj komisioni edhe këtë vendim përcolli mbledhjes plenare dhe votoi :

R e k o m a n d i m

Të miratohet nga mbledhja plenare Vendimi i Qeverisë Nr. 05/167 dt. 22 janar 2014, për hartimin e Planit Hapësinor të Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”.

6. Të ndryshme

Në pikën të ndryshme u miratuan si vijon :

Për Amendamentet në projektligjin e **NP për Regjistrimin e bujqësisë** deputeti **Nijazi Idrizi** konstatoi se poçes janë zgjedhjet lokale arsyeja pse nuk ka përfunduar regjistrimi i bujqësisë, atëherë edhe ky vit është vit zgjedhor dhe plotësim ndryshimi i këtij ligji për te njëjtat arsye prapë nuk do të mund të zbatohet, ndaj nisur nga një arsyetim i tille për moszbatimin e këtij ligji vitin e kaluar, ai preferoj të abstenoj.

Amendamenti 1

Neni 1, riformulohet si vijon :

Neni 1, i ligjit bazik, paragrafi 1. fjala **“Vitin 2013”** zëvendësohet me fjalën **“Vitin 2014”**.

Amendamenti 2

Neni 2 riformulohet si vijon :

1. Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 1., periudha kohore **“01-20 Nëntor 2013”** zëvendësohet me periudhën kohore **“01 - 30 qershor 2014”**.

2. Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 2, nënparagrafi 2.1, periudha kohore **“31 tetor 2012 deri 01 Nëntor 2013”** zëvendësohet me periudhën kohore **“31 tetor 2013 deri me datë 01 nëntor 2014”**.

3. Neni 7, paragrafi 2, nënparagrafi 2.2, data **“01 Nëntor 2013”** zëvendësohet me datën **“01 qershor 2014”**.

4. Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 2, nënparagrafi 2.3, periudha kohore **“31 Tetor 2012 deri 01 nëntor 2013”** zëvendësohet me periudhën kohore **“12 muajt e fundit”**.

5. Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 2, nënparagrafi 2.4, data: **“31 Dhjetor 2013”** zëvendësohet me datën **“31 dhjetor 2014”**.

6. Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 4, periudha kohore **“01 - 15 dhjetor”** zëvendësohet me periudhën kohore **“01 – 30 korrik 2014”**.

Amendamenti 3

Neni 3 riformulohet si vijon :

1. Neni 13 i ligjit bazik, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, data: **“28 shkurt 2014”** zëvendësohet me datën **“30 shtator 2014”**.

2. Neni 13 i ligjit bazik, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, data: **“30 shtatori 2014”** zëvendësohet me datën **“30 prill 2015”**.

Amendamenti 4

Neni 4, riformulohet si vijon :

1. Neni 14 i ligjit bazik, paragrafi 4, data: **“28 Shkurt 2014”** zëvendësohet me datën **“30 shtator 2014”**.

2. Neni 14 i ligjit bazik, paragrafi 5, togëfjalëshi: **“pas datës 28 shkurt 2014”** zëvendësohet me togëfjalëshin: **“pas datës 30 shtator 2014”**.

Amendamenti 5

Pas **Nenit 4** shtohet Neni ri si vijon :

Neni 5

(Neni 5 i projektligjit bëhet Neni 6)

Neni 15 i ligjit bazik, paragrafi 2, data **“28 shkurt 2014”** zëvendësohet me datën **“30 shtator 2014”**.

Gjithashtu u miratuan Amendamentet për Projektligjin për **NP për Shitjen e banesave**(abstenoj deputeti **Faton Topalli**) :

Amendament 1

Neni 1 i projektligjit fshihet.

Amendamenti 2

Neni 2, riformulohet si vijon:

Në nenin 7 të Ligjit bazik, në paragrafin 3. togfjalëshi afati: **“dy (2) vitesh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji”**, zëvendësohet me togfjalëshin : **“tri (3) vitesh, nga data e hyrjes në fuqi të ligjit bazik”**.

Amendamenti 3

Neni 3, riformulohet si vijon:

Neni 32 i ligjit bazik, në rreshtin e parafundit pas fjalës **“të vlefshme”** pjesa tjetër e fjalisë riformulohet si vijon: **“deri në tri (3) vite, nga data e hyrjes në fuqi të Ligjit bazik.”**

Ramiz lladrovci propozoi që në dy Amendamentet të përdoret fjala **“nga data e hyrjes....”** në vend të **“pas datës së hyrjes...”**.

Gjatë javës që vjen, vazhdoi **kryetari**, do të kryhen vizitat e parapara rreth projektligjit për mbrojtjen nga Zhurma në Prizren dhe Graçanicë dhe do të aranzhohen mundësisht sipas propozimeve të shumicës së anëtarëve të komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 12,10.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani